



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Komisioneri

Nr. 40 Prot

Tiranë, më 12/09/2011

**Lënda :** Mbi kundërvajtjen administrative të kontrolluesit **SPITALI OBSETRIK GJINOKOLOGJIK “NËNA GERALDINË”**.

**VENDIM**

Nr. 3, datë 12/09/2011

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të **Spitali Obsetrik Gjinokologjik “NËNA GERALDINË”** ;

**KONSTATOVA**

Sipas ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ju keni cilësinë e Kontrolluesit, pra përgjegjësinë për përpunimin e të dhënave personale dhe si i tillë keni detyrimin të zbatoni të gjitha kërkesat e këtij ligji dhe në mënyrë të veçantë të detyrimit të parashikuar në nenin 21 të tij.

Në pikën 1 të nenit 21 të ligjit të sipërm parashikohet : “Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë. Ndërsa në nenin 22 saktësohet përmbajtja e të dhënave që përpunoni, të cilat duhet t’i njoftoni tek Komisioneri..

Për zbatimin e këtij detyrimi nga ana e jonë, me shkresën nr.487, datë 17.05.2010, ju është dërguar një informacion me shpjegimet se si do të plotësoni formularin e njoftimit të të dhënave personale që përpunoni. Gjithashtu në këtë shkresë ju kemi caktuar dhe afatin kohor, 07.06.2010, brenda së cilës keni qënë përgjegjës për ta plotësuar.

Përsëri me shkresën nr.4423, datë 13.10.2010, nëpërmjet postës elektronike, ju kemi kërkuar bashkëpunim në lidhje me zbatimin e detyrës ligjore të njoftimit të të dhënave që përpunoni.

Veç këtyre, nga Drejtoria e Inspektimit është kryer inspektimi pranë autoritetit tuaj në muajin Prill 2010 dhe është konstatuar se nuk e keni zbatuar detyrimin ligjor të sipërm.

Po kështu, nga verifikimi e regjistrave të Drejtorisë së Regjistrimit të këtij institucioni rezulton se deri më datë 12.09.2011, ende nuk keni depozituar formularin e plotësuar të njoftimit.

Moskryerja e kësaj detyre ju ngarkon me përgjegjësi administrative të parashikuar në nenin 39 pika 1, gërma “d”, të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ku parashikohet dënimi me gjobë nga 10.000 deri në 50.000 lekë.

Për zgjedhjen e masës së gjobës Komisioneri ka parasysh shkallën e njohjes dhe masat që keni marrë për implementimin e ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Nisur sa më sipër, në zbatim të neneve 21-23, 30/2, 39/1,4; 40 e 41, të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

#### V E N D O S A

1. Dënimin e Kontrolluesit, **SPITALI OBSETRIK GJINOKOLOGJIK “NËNA GERALDINË”**, me gjobë lekë 50.000 (pesëdhjet mijë) lekë.
2. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i këtij vendimi.  
Me kalimin e këtij afati, ky vendim shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e rrethit gjyqësor, Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

Ky vendim u dha sot me datë 12.09.2011.

**Komisioneri**

**Flora Çabej (Pogaçe)**

